



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi _ dhe nenit 23 të Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 42-të me datë 11.12.2020 morri:

VENDIM

Procedura për lëndën numër 12-1401 të viti 2020, e formuar me shënim zytrat për transfer të lëndës nr. 12-11401/1 me datë 26.02.2020, dhe në lidhje me denoncimin numër 09-2940 me datë 30.05.2019 dorëzuar nga parashtruesi, **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën 12-1401 nga viti 2020.

Lënda me numër 12-1401 nga viti 2020, të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-1401 nga viti 2020, është formuar në bazë të shënimit zyrtar për transfer të lëndës me numër 12-1401/1 me datë 26.02.2020, me të cilën lënda numër 09-2940 nga viti 2020 i formuar pas denoncimit 09-2940/1 me datë 30.05.2019 dorëzuar nga ish-deputeti, për keqpërdorim të detyrës zyrtare nga ana e ish-ministrit për punë të brendshme e tjerë, transferohet në punë dhe veprim në Njësinë për parandalim të korrupsionit pran Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit.

Denoncimi i dorëzuar përmbanë akuza kundër ish-ministrit në Ministrinë për punë të brendshme dhe ish zëvendës-drejtor në Drejtorinë për siguri dhe kundërzbulim pran Ministrisë së punëve të brendshme, i pensionuar – i angazhuar me të drejtë autoriale, për shkak të dyshimeve për vepra kundër detyrës zyrtare, korrupsion, konflikt të interesave dhe nepotizëm.

Me datë 11 Mars të viti 2020, me kërkesë të KSHPK në hapsirat e KSHPK është mbajtur takim pune me zonjën, në cilësi si ndihmës i ministrit në sektorin për qështje juridike dhe menaxhim me resurse njerzore pran Ministrisë për punë të brendshme të RMV, kurse për vërtetim të plotë të gjendjes faktike të lëndës së hapur dhe sqarimit të qështjeve të caktuara në lidhje me marrjen e vendimit në kompetenca të veta me kompetenca dhe procedurë për lëndën e hapur. Njëherit, nga Prokuroria themelore publike Shkup janë kërkuar të dhëna dhe informacione për veprimin e tyre kompetent për kallëzim penal të dorëzuar deri tek ato nga, dorëzuar kundër personave të përmendur.

Pas kërkesës së Komisionit shtetëror është dorëzuar lajmërim me informacionet e kërkuara me shtesë dokumentacion dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës, nga ana e KSHPK është caktuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për dyshime në lidhje me njohuritë deri tek të cilat erdhi parashtruesi i denoncimit për dyshime për elemente për korrusion të mundshëm dhe veprime kundërligjore të kryera nga ana e ish ministrit për punë të brendshme gjatë procedurës për pensionim të personit, ish zëvendës drejtori i Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim pran Mistrisë së punëve të brendshme, të cilit iu mundësua vazhdim të afatit për pensionim dhe i cili kundër drejtësisë qëndroi në punë dhe në kundërshtim me ligjin ishte përdorues i rrogës bazë dhe shtesa të rrogës jashta ligjit për periudhë prej tri vitesh.

Nga ana e parashtruesit të denoncimit në lidhje me informacionet e fituara në lidhje me rastin e përmendur janë informuar personat, ndihmës ministër aktuat për çështje juridike dhe kadrovike pran MPB dhe, ministrë aktual për punë të brendshme, dhe në drejtim të inspektimit të sërishëm të procedurës për lëndën.

Sipas parashtruesit, procedurat e theksuara ishin zbatuar jashta rregullativave ligjore dhe pa bazë ligjore për të njëjtat, kurse Vendimi i dhënë nga ana e ministrit të atëhershëm për punë të brendshme ka qenë joligjore në tërësi, për arsye se në kohën e vendimmarrjes së Vendimit për vazhdim të kontratës së punës të punëtorit nuk ka pasur asnjë bazë ligjore për atë. Në denoncim theksohet se nga informacionet të cilat janë fituar nga MPB marrëveshja për angazhim të është dokument i klasifikuar me shenjë "sekret shtetëror", dhe në përputhje me ligjin dhe mundësitë për qasje deri tek informacione të karakterit publik, të drejtat autoriale të këtij lloji nuk iu nënshtrohen në shkallën e klasifikimit të nivelit më të lartë – sekret shtetëror.

- Në pjesën të denoncimit theksohet se personi ka qenë i punësuar në DSK pa shpallje publike, në periudhën kur babai i tij ka qenë zëvendës drejtor i të njëjtës institucion. Nga dokumente e ofruara në denoncim shihet se personi ka qenë i punësuar në DSK me datë 13.06.2012.
- Në denoncimin e dorëzuar, parashtruesi kërkon që KSHPK të vepron në përputhje me kompetencat e veta në lidhje me akuzat e lëndës dhe njëherit informon se nga vetë fakti që në rastin e lëndës ekzistojnë elemente evidente për vepra penale kundër detyrës zyrtare për të cilat KSHPK nuk ka kompetenca ligjore të vepron, denoncimi për lëndën me datë 28.05.2019 ka qenë dorëzuar për procedurë kompetente deri në Prokurorinë themelore publike Shkup, për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve dhe punës pakujdesi në detyrë dhe atë fillimisht kundër dy personave (..... dhe), dhe pastaj denoncimi ishte zgjërur edhe për një person
- Nga takimi i punës të mbajtur me datë 11.03.2020 me zonjën, në cilësi të Ndihmës-ministrit në sektorin e çështjeve juridike dhe menaxhimit me resurse njerzore pran Ministrisë së punëve të brendshme të RMV, KSHPK, erdhi deri tek informacionet se:
 - o Vendimet e marrura për pensionim, për shfuqizim dhe për angazhim të personit të përmendur në MPB, janë përgaditur nga ana e sektorit për çështje juridike dhe menaxhim me resurse njerzore dhe nënshkrua nga ministri i atëhershëm, me kërkesë për vazhdim të kontratës së punës të dorëzuar nga personi i përmendur

- (.....) dhe të cilën kërkesë ka mundur ta dorëzon në përputhje me nenin 104 të Ligjit për marrëdhënje pune, në të cilin është paraparë se punëtori me deklaratë të shkruar deri tek punëdhënësi mund të kërkon që t'i vazhdohet kontrata për punë më së shumti deri në moshë 67 vjeçare.
- Gjatë përgaditjes dhe vendimmarrjes të vendimeve të marrura nga ana e MPB janë respektuar dispozitat nga Ligji për organizim dhe punë të organeve të administratës së shtetit dhe Ligjit për punë të brendshme, si dhe Ndryshimet në Ligjin për ndryshime dhe plotësime në Ligjit për punë të brendshme i cili ka qenë miratuar në atë periudhë dhe me të cilin parashihet mundësia për vazhdim të kontratës së punës deri në 45 vjetë të stazhit pencional
 - Me datë 26.04.2019, deri në KSHPK është dorëzuar lajmërim nga ana e Prokuroia themellore publike Shkup, me shtojcë dokumentacion me të cilën lajmërohet se:
 - Me datë 28.05.2019 nga ana e ka qenë dorëzuar kallëzim penal kundër dhe, për vetër penale – keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit nga neni 353 paragrafi 1 v.v me paragrafin 1 nga Kodi Penal dhe vepër penale – punë pakujdesi në detyrë nga neni 353-v paragrafi 2 v.v me paragrafin 1 nga Kodi Penal, kurse me datë 22.11.2019 ka qenë dorëzuar plotësim i kallëzimit penal, me të cilën ka qenë denoncuar personi për veprat e njëta penale;
 - Pas kontrollimeve të bëra në procedurë parahetimorë është marrë vendim KO nr./.....me datë 20.12.2019 me të cilën rrefuzohet kallëzimi penal, sepse veprat e denoncuar nuk janë vepra penale për të cilat ndiqet sipas detyrës zyrtare;
 - Për vendimin e marrë, parashtruesi i kallëzimit penal ka qenë informuar me lajmëtim KO nr/11 me datë 20.12.2019 e cila i është dorëzuar nëpërmjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Veriut
 - Gjatë inspektimit të bërë KSHPK erdhi deri në njohur se në lidhje me akuzat e lëndës për punësim të personit është vepruar nga ana e Njesisë për parandalim të konfliktit të interesave pran KSHPK me çka është marrë përfundim lënda të mbyllet dhe arkivohet në këtë njësi, për shkak se KSHPK nuk ka elemente për ngritje të procedurës për vërtetim të gjendje së konfliktit të interesave, në përputhje me nenin 78 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, për faktin që punësimi i, e cila është e bija e, ish zëvendës drejtor në DSK është realizuar në vitin 2012, dhe prej këtu KSHPK nuk ka mundësi të vepron në përputhje me nenin 17 paragrafi 1 pika 4 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, sepse nuk mund të ngritet Iniciativë për ngritje të procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë sepse personi zyrtar nuk e kryen më funksionin e zëvendës drejtor në DSK.

Në bazë të gjendjes faktike të caktuar më sipër, KSHPK konstaton se në rastin e lëndës është vepruar nga ana e organeve kompetente (PTHP Shkup dhe Njësia për parandalim të konfliktit të interesave pran KSHPK), me çka vlerëson se Komisioni shtetëror nuk ka elemente për veprim të vetin në rastin e lëndës, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasyshë të theksuarën më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dispozitat e këtij vendimi.

Ёshtё vendosur me 11 Dhjetor 2020, me numёr 12-1401/7

Dorёzuar deri tek: Arkiva dhe parashtruesi
Pas mbarimit tё KSHPK
Punoi: J.C., kёshilltarё
Miratoi: B.I. kryetarё i KSHPK

**KOMISIONI SHТETЁROР PЁR
PARANDALIM TЁ KОРРУPSIONIT**
Krytar: Biljana Ivanovska

